



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 30/11

Prishtinë, më 11.10.2011, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Sali Asllanaj, Hykmete Bajrami, Latif Gashi, Muhamet Mustafa, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziraj, Duda Balje dhe Hasime Krasniqi.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Avni Jashari nga AKP, Arben Citaku nga MMPH-së, Rejhane Zylfijaj dhe Ramadan Islami nga GIZ, monitorues nga KDI dhe OSCE.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli dhe Aurora Ademi (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e mbajtur më datë 29.09.2011;**
- 3. Shqyrtimi i kërkesë së Agjencisë Kosovare të Privatizimit për transferimin e mjeteve buxhetore;**
- 4. Shqyrtimi i kërkesë së Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për transferimin e mjeteve buxhetore;**
- 5. Shqyrtimi i kërkesë së Zyrës së Rregullatorit për Ujësjetës dhe Mbeturina për buxhet shtesë për kompensimin e Kryesuesit të Komisionit Shqyrtues për zgjidhjen e ankesave ndaj vendimeve të Rregullatorit;**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-53 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së;**
- 7. Shqyrtimi i Projektligjit për Hekurudhat e Kosovës, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**

8. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-65 për Të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;
9. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-36 për Statistikat Zyrtare në Republikën e Kosovës , me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;
10. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-48 për tregti me jashtë, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;
11. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, hapi mbledhjen dhe propozoi që në të ndryshme të diskutohet rekomandimi i Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore për përshkrimin e fushëveprimtarisë së Komisionit për Buxhet dhe Financa, në kuadër të aktiviteteve për ndryshimit e rregullores së punës së Kuvendit.

Rendi i ditës miratohet me këtë plotësim.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e komisionit më datën 29.09.2011

Procesverbali miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për transferimin e mjeteve buxhetore

Kryetarja, njoftoi se kërkesa e AKP-së ka të bëjë me transferimin e mjeteve buxhetore nga investimet kapitale, programi i Administratës Qendrore, nga projekti “Riparimi i ndërtesës së AKP-së dhe zyrave regjionale” në vlerë prej 30.000 € dhe nga projekti i dytë që është “Zhvillimi i softuerit për administrimin financiar të fondeve në mirëbesim” në vlerë prej 45.000 €, në programin e likuidimit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Sipas nenit 30.4 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nëse udhëheqësi i organizatës buxhetore kërkon nga Ministri që të autorizojë transferin e një shume të barabartë me njëzet e pesë (25%) apo më shumë të ndarjes së ndikuar negativisht, Ministri mund të autorizojë transferin e tillë vetëm pas marrjes së miratimit me shkrim nga Kuvendi. Kryetarja kërkoi sqarime nga përfaqësuesi i AKP-së për mosrealizimin e këtyre projekteve kapitale të parapara, te programi i likuidimit për të cilin edhe është kërkuar të bëhet transferi sa është planifikuar të shpenzohet brenda vitit, sa është vlera e borxheve dhe sa publikime kanë planifikuar që t’i bëjnë deri në fund të vitit?

Avni Jashari, sqaroi se duke shfrytëzuar ekspertizën e brendshme është arritur zhvillimi i një softueri që i plotëson të gjitha nevojat e raportimit të brendshëm si për menaxhmentin ashtu edhe për bordin e drejtorëve, për këtë arsye projekti “Zhvillimi i softuerit për administrimin financiar të fondeve në mirëbesim nuk është paraparë në buxhetin e vitit 2012 dhe kjo llogaritet si një kursim nga ana e AKP-së të një shume në vlerë prej 45.000 €. Ndërsa për projektin “Riparimi i ndërtesës së AKP-së dhe zyrave regjionale” është arritur përfundimi që nuk ka nevojë të realizohet në këtë vit, për shkak se një pjesë e zyreve nuk do të përdoren. Për këto arsye prioritetet janë bartur nga administrata qendrore në programin e likuidimit. Sipas Ligjit për AKP-në, vitin e kaluar Bordi i Drejtorëve për programin e likuidimit e ka aprovuar kërkesën në shumën 861.104 €, ndërsa gjatë procesit të

dëgjimeve buxhetore që janë mbajtur me Ministrinë e Financave, kjo kërkesë është shkurtuar në 641.000 € dhe nëse ka nevojë për mjete shtesë, atëherë do të shqyrtohen në procesin e rishikimit gjysëmvjetor. Meqenëse nuk ka pasur rishikim buxhetor, është bërë kërkesa e brendshme dhe tani ndarja buxhetore për programin e likuidimit është 752.000 €, duke përfshirë edhe shumën prej 75.000 €, e cila shumë i plotëson nevojat deri në fund të vitit. Sipas planit të pagesave deri në fund të vitit, parashihet që edhe 117.000 € të shpenzohen dhe atë për publikimin e listave fillestare të punëtorëve në vlerë prej 93.000 € dhe për shpalljet për procesin e likuidimit 24.000 €.

Sali Asllanaj, kërkoi sqarime për këtë transfer të mjeteve buxhetore se a është kjo si pasojë e planifikimit të keq të shpenzimeve vjetore dhe pyeti se çka ndodhë nëse nuk paguhen këto mjete në këtë vit gjatë likuidimit?

Avni Jashari, sqaroi se planifikimi i AKP-së ka qenë i saktë, mirëpo arsyeja qëndron në faktin që kërkesa buxhetore në vlerë prej 861.000 € është shkurtuar nga Ministria në 641.000 € të cilat nuk kanë qenë të mjaftueshme për programin e likuidimit.

Agim Krasniqi, theksoi që në mungesë të procesit të rishikimit, Ministria është detyruar që t'i zgjidhë vetëm ato probleme që janë brenda ligjit. Mirëpo në tetor është një mundësi që në raste të veçanta Ministri deri në vlerën 5% të shumës totale të bëjë rregullimet e brendshme. Meqenëse këto kërkesa kanë ardhur më herët, ato i kemi adresuar në Kuvend. Kërkesa e AKP-së është analizuar dhe rekomandoi që kjo kërkesë të aprovohet.

Muhamet Mustafa, sugjeroi që softueri të realizohet sa më shpejt, sepse edhe në rastet kur bëhet planifikimi i mirë mund të paraqitet nevoja për përshtatje.

Hykmete Bajrami, parimisht ishte kundër riallokimi të fondeve, veçanërisht prej investimeve në material shpenzues, duke pasur parasysh vonesën e AKP-së në shpërndarjen e 20%-shit punëtorëve. Sipa sqarimeve të përfaqësuesit të AKP-së, u tha që është zhvilluar një softuer dhe nëse komisioni e aprovon riallokimin e fondeve, atëherë duhet që në vitet vijuese të mos pranohet asnjë kërkesë për një softuer nga AKP-ja. Pyeti pse listat publikohen në shtypin ndërkombëtar dhe ku publikohen? Nëse është fjala për punëtorët serbë që nuk jetojnë në Kosovë, atëherë do të ishte më mirë që të vendosen në webfaqe e jo të bëhen shpenzime të pa arsyeshme. Rekomandoi që kjo kërkesë të aprovohet me kusht që në dy vitet vijuese të mos vinë kërkesa për zërat për të cilët po bëhet riallokimi.

Avni Jashari, sqaroi se AKP-ja sipas ligjit është e obliguar të bëjë publikimin e listave të punëtorëve dy herë, në shtypin vendor në gazetatat me tirazhin më të madh dhe në shtypin ndërkombëtar që përfshin një gazetë në Serbi dhe një në Mal të Zi.

Pas diskutimeve, komisioni me nëntë vota për (Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Duda Balje, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Muhamet Mustafa, Sali Asllanaj dhe Xhevdet Neziraj), asnjë kundër, dhe dy abstenime (Hykmete Bajrami dhe Albana Fetoshi) nxori këtë

REKOMANDIM

- I. I rekomandohet Kuvendit të miratojë kërkesën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për transferin e mjeteve nga kategoria ekonomike Investime Kapitale – Programi i Administratës Qendrore (kodi 229), nga projektet:
 - a. "Riparimi i ndërtesës së APK-së dhe zyrave regjionale" (kodi i projektit 12429), në vlerë prej 30.000€, dhe

- b. "Zhvillimi i softuerit për administrimin financiar të fondeve në mirëbesim" (kodi i projektit 11194), në vlerë prej 45.000 €,
- në kategorinë ekonomike Mallra dhe Shërbime - Programi i Likuidimit (kodi 227), në vlerë prej 75.000 €.

4. Shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për transferimin e mjeteve buxhetore

Kryetarja, sqaroi që kërkesa ka të bëjë me transferin e mjeteve buxhetore nga investimet kapitale në vlerë prej 50.000 € në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, konkretisht me projektin për binjakëzim të Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit me Agjencionin Mjedisor të Austrisë dhe Finlandës. Për këtë projekt që është në bashkëfinancim me IPA-n, është paraparë që një pjesë të financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës. Meqenëse, shuma e kërkuar për transfer është e barabartë me 50% të ndarjes së ndikuar negativisht, atëherë kërkohet që Kuvendi i Republikës së Kosovës të shqyrtojë këtë kërkesë për aprovim të transferit, ashtu siq kërkohet me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike. Kërkoi nga përfaqësuesi i Ministrisë sqarime se kur do të fillohet me shpenzime dhe si janë paraparë ato, me çfarë emërtimi do të përfshihen në kuadër të kategorisë mallra dhe shërbime dhe si do të figurojë ky projekt në të ardhmen në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve?

Arben Citaku, njoftoi se Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit është anëtarësuar me të drejta të plota në rrjetin e Agjencioneve Evropiane për Raportim dhe si i tillë i ka disa obligime që duhet përmbushur. Në kuadër të programit me IPA-n, është projektuar binjakëzimi me Agjencionet simotra të shteteve evropiane, në mënyrë që të shkëmbehen përvojat dhe të adoptohen të njëjtat sisteme të raportimit dhe monitorimit të mjedisit që i bëjnë vendet evropiane. Për këtë projekt ka qenë kusht që të bashkfinancohet në vlerën prej 10%, vlera e projektit që është përfituar nga Komisioni Evropian është 1.000.0000 €, që do të thotë se 100.000 € kanë qenë të parapara të financohen nga buxheti i Republikës së Kosovës për dy vite. Pas nënshkrimit të kontratës me Komisionin Evropian ka ardhur aneksi që përshkruan se këto mjete të financuara nga buxheti i Republikës së Kosovës do të shpenzohen për shpenzime operative të zyrës së projektit në Kosovë, e cila është themeluar në MMPH. Kjo vlerë në vitin 2012 do të figurojë në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

Agim Krasniqi, sqaroi çështjen e përcjelljes së projekteve që kanë të bëjnë me donatorët, e kryesisht me IPA-n se është një problem, për shkak se shumica e agjencioneve kontaktojnë direkt me Komisionin Evropian dhe i bëjnë vetëm projektet ideore pa i specifikuar përgjegjësitë e Ministrisë dhe të Komisionit Evropian. Në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes është kuptuar që pjesa e shpenzimeve operative duhet të mbulohet nga buxheti i Republikës së Kosovës. Rekomandimi nga ana e Ministrisë së Financave është pozitiv.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit të miratojë kërkesën e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për transferin e mjeteve:

- nga Programi i Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit (kodi 436), kategoria ekonomike Investime Kapitale, projekti, "Projekti i binjakëzimit të Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit me Agjencionet mjedisore të Austrisë dhe Finlandës "(kodi i projektit 12709), në vlerë prej 50.000 €,
- në Programin e Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit (kodi 436), në kategorinë ekonomike Mallra dhe Shërbime, në vlerë prej 50.000 €.

5. Shqyrtimi i kërkesës së Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Mbeturina për buxhet shtesë për kompensimin e Kryesuesit të Komisionit Shqyrtues për zgjidhjen e ankesave ndaj vendimeve të Rregullatorit

Kryetarja, kërkoj sqarime nga përfaqësuesi i ZRRUM-it pse nuk është paraparë paga e kryesuesit të komisionit në planifikimet e buxhetit, sepse tani në fund të vitit është problem që të përcaktohet paga e këtij kryesuesi.

Raif Preteni, theksoi që në organogramin e ZRRUM-it nuk është paraparë pozita për këtë kryesues, pasi që nuk ka pasur asnjëherë ankesa ndaj vendimeve të ZRRUM-it. Mirëpo, me rastin e shqiptimit të gjobave në bazë të ligjit kanë filluar edhe ankesat ndaj vendimeve të ZRRUM-it dhe kjo ka paraqitur nevojën që të bëhet emërimi i kryesuesit të Komisionit Shqyrtues për zgjidhjen e ankesave ndaj vendimeve të Rregullatorit. Emërimi i këtij kryesuesi është bërë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, i cili duhet të paguhet nga ZRRUM-i. Meqenëse, kryesuesi nuk ka qenë me kohë i emëruar, për këtë arsye edhe nuk është paraparë për vitin 2011 buxhet kompensimin e këtij kryesuesi. Pasi që ZRRUM-i është themeluar dhe i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe pagat përcaktohen nga Kuvendi, atëherë nuk është caktuar ndonjë shumë fikse për pagën e kryesuesit të komisionit.

Kryetarja, theksoi Kuvendi nuk i përcakton paga askujt, vetëm në bazë të ligjit i shqyrton kërkesat buxhetore dhe i analizon se a përputhen me ligjin. Kompensimi për kryesuesin e komisionit duhet të zgjidhet brenda ZRRUM-it, sepse Komisioni shqyrtues nuk është organ që themelohet nga Kuvendi.

Hykmete Bajrami, pyeti se prej kujt përbëhet ky komision, pasi që nuk ka pasur ankesa ndaj ZRRUM-it dhe kryesuesi nuk ka figuruar në organogramin e Rregullatorit, atëherë edhe komisioni nuk paska figuruar në organogram.

Raif Preteni, sqaroi se sipas nenit 34 komisioni përbëhet nga Kryesuesi i cili zgjidhet nga Kuvendi, një anëtar nga Rregullatori dhe një anëtar nga ofruesi i shërbimeve, i cili parashtrohet kërkesën për shqyrtim.

Agim Krasniqi, theksoi që me rastin e zgjidhjes së këtij problemi duhet të jetë parim që të definohen këto komisione, se a janë të rregullta se si do të paguhet, pasi që këto nuk janë vende të punës, por kryejnë punë të kohëpaskohshme dhe mbi bazën e kësaj, këto komisione duhet të paguhet me një honorar të caktuar. Ky pozicion nuk është i planifikuar as për vitin e ardhshëm, për të cilin duhet të caktohet një honorar nga ZRRUM-i, i cili do të paguhet në baza mujore.

Naser Osmani, u pajtua që pagesa duhet të bëhet në formë të mëditjeve, e jo si pagë e rregullt ashtu siç është kërkuar.

Latif Gashi, theksoi që në kërkesë të ZRRUM-it është shkruar që nuk ka mjete financiare për të bërë kompensimin e kryesuesit brenda Rregullatorit.

Kryetarja, theksoi që Qeveria është dashur të procedojë projektligjin, i cili do t'i rregullonte pagat e funksionarëve të lartë publik. Pasi që Kuvendi nuk merret me përcaktimin e pagave e mëditjeve.

Komisioni njëzëri nxorri këtë:

REKOMANDIM

Komisioni shqyrtues nuk është Organizatë Buxhetore e as organ i caktuar nga Kuvendi, me përjashtim që emërimi kryesuesit të këtij komisioni bëhet nga Kuvendi. Komisioni për Buxhet dhe Financa vlerësoi se Kuvendi ka miratuar buxhetin e Zyrës së Rregullatorit për Ujësjiellës dhe Mbeturina për vitin 2011. Zyrë e Rregullatorit për Ujësjiellës dhe Mbeturina të gjejë mundësinë e kompenzimit të mëditjeve për kryesuesin e komisionit nga buxheti i ZRRUM-it, me rastin shqyrtimit të ankesave të ofruesve të shërbimeve ndaj vendimeve të Rregullatorit.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-53 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyerje të FSK-së

Komisioni njëzëri nxorri këtë:

R E K O M A N D I M

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

7. Shqyrtimi i Projektligjit për Hekurudhat e Kosovës, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Kryetarja, theksoi nenin 37 që ka të bëjë me organin për hetimin e aksidenteve hekurudhore, që parashihet se ky organ mund të propozojë staf profesional dhe me përvojë të cilat kanë kapacitete të kryejnë detyrat e përcaktuara. Nëse mbetet kështu siç është në projektligj, atëherë ata mund të propozojnë sa të duan persona, dhe propozoi që të fshihet kjo pjesë.

Albana Fetoshi, pyeti nëse mund të kufizohet numri i këtij stafi që do të zgjidhet nga ky organ?

Kryetarja, u përgjigj se nuk kanë të drejtë të propozojnë, sepse ky staf duhet të zgjidhet me konkurs ashtu siç parashihet me Ligjin për Shërbyesit Civil.

Komisioni njëzëri vendosi që të fshihet fjalia e dytë e nenit 37 “i njëjti duhet të propozojë staf profesional dhe me përvojë, të cilët kanë kapacitete të kryejnë detyrat e përcaktuara më këtë ligj.”

Kryetarja, sqaroi se në nenin 35 komisioni funksional e ka rritur numrin e anëtarëve të Bordit nga tre në katër anëtarë.

Hykmete Bajrami, kundërshtoi rritjen e bordit në katër anëtarë, pasi që kjo nuk është e nevojshme.

Muhamet Mustafa, thekoi se kryesuesi nuk duhet të ketë votë të dyfishtë

Kryetarja, sqaroi se nëse vendoset që të mbesin katër anëtarë, atëherë duhet të hiqet vota e dyfishtë.

Komisioni njëzëri vendosi në paragrafin 6.12 të nenit 38, të fshihet fjalia e dytë si në vijim:

“Çdo anëtar i Bordit ka një (1) votë për çdo zgjidhje dhe kur numri i votave në favor të zgjidhjes është i barabartë me numrin e votave kundër, vota e kryesuesit është vendimtare.”

Komisioni njëzëri vendosi që të fshihet paragrafi 16 e nenit 39, i cili vlerësohet me implikime të mundshme buxhetore.

Po ashtu komisioni njëzëri u nuk përkrahu amendamentin 4 i komisionit funksional, për shkak të vlerësimit të implikimeve buxhetore shtesë që krijon amendamenti.

Komisioni njëzëri nxorri këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 04/L-63 për Hekurudhat e Kosovës nuk përmban implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të nenit 37, nenit 38 paragrafi 16.12, dhe nenit 39 paragrafi 16.
2. Amendamente e propozuara nga Komisioni funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, për Projektligjin nr. 04/L-63 për Hekurudhat e Kosovës, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të amendamentit 41. Komisioni rekomandon që të fshihet amendamenti 41, për shkak se përmban implikime buxhetore shtesë.

8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-65 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Komisioni njëzëri nxorri këtë:

REKOMANDIM

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

9. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-36 për Statistikat Zyrtare në Republikën e Kosovës, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Komisioni njëzëri nxorri këtë:

REKOMANDIM

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

10. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-48 për tregti me jashtë, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Komisioni njëzëri nxorri këtë:

REKOMANDIM

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

11. Të ndryshme

11.1 Rekomandimi i Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit të Kosovës

Kryetarja, njoftoi që Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore ka rekomanduar që Komisioni për Buxhet dhe Financa të bëjë përshtesë të fushëveprimtarisë dhe përgjegjësisë të veta dhe brenda dy javëve t'ia përcjellë Nënkomisionit.

Hykmete Bajrami, propozoi që të gjitha komisionet të kenë mundësi të shqyrtojnë buxhetin e sektorit përkatës.

Kryetarja, sqaroi se edhe në rregulloren e punës së Kuvendit është e shënuar që çdo komision e shqyrton buxhetin e sektorit që i takon. Mirëpo, komisionet tjera nuk kanë të drejtë të bëjnë direkt rekomandime në Kuvend, por i sjellin në Komisionin për Buxhet dhe Financa.

Muhamet Mustafa, theksoi se duhet në këtë rast duhet të kanalizohen gjërat dhe nëse është nevoja edhe të mbahen takime, sepse kjo është çështja kryesore që i takon komisionit. Përshkrimi aktual i fushëveprimtarisë së komisionit e thjeshtëson punën e këtij komisioni në aspektin e një evidence lidhur me buxhetin. Një rol shumë i rëndësishëm i këtij komisioni është stabiliteti makroekonomik dhe fiskal si dhe bashkëpunimi me institucionet financiare ndërkombëtare dhe shqyrtimi marrëveshjeve me këto institucione.

Sali Asllanaj, nuk u pajtua me atë që ne vet t’ia përshkruajmë detyrat vetvetes, mirëpo Kuvendi duhet t’i përshkruajë kompetencat tona.

Kryetarja, propozoi që këto sugjerime nga anëtarët e komisionit të sjellin me shkrim në administratën e komisionit dhe në mbledhjen e radhës të vendoset për këtë çështje.

Kryetarja, po ashtu i njoftoi anëtarët e komisionit se projektligjet që janë miratuar në mbledhjen e kaluar janë miratuar nga komisionet tjera të përhershme, përveç Projektligjit për Financimin e Subjekteve Politike, për të cilin kanë ardhur disa vërejtje nga Komisioni për Legjislacion dhe Integritet Evropian.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj